



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 21, datë 11.06.2025



PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMET E KËSHILLIT BASHKIAK TË LISTËS SË PËRFITUESVE, BANORË NË PALLATET E DËMTUARA NË NJËSITË ADMINISTRATIVE SUKTH, KATUND I RI SI DHE NJËSITË ADMINISTRATIVE NR.3 DHE NR.4, BASHKIA Durrës, TË CILËT KANË PËRFITUAR NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT TË ZONËS SË RE PËR ZHVILLIM, SIPAS VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 164, DATË 19.2.2020, “PËR SHPALLJEN E ZONËS SË RE PËR ZHVILLIM, NË NJËSINË ADMINISTRATIVE Durrës, BASHKIA Durrës, DHE CAKTIMIN E FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT SI NJËSI ZBATUESE”

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, Ligjit nr. 44/2015, Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me Ligjin nr. 97/2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituese nga disa programe të procesit të rindërtimit” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.164, datë 19.2.2020, “Për shpalljen e Zonës së Re për Zhvillim, në Njësine Administrative Durrës, Bashkia Durrës, dhe caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si njësi zbatuese”, Urdhërit nr. 164, datë 01.07.2020 “Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit” i ndryshuar, si dhe relacionit përkatës hartuar nga Komisioni i Posaçëm, me propozim të Komisionit të Rregullores, Çështjeve Juridike,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e ndryshimit të VKB-së nr. 152, datë 18.10.2023 “Për miratimin e disa shtesave në Aneksin 1, bashkëlidhur VKB-së nr. 62, datë 17.03.2023, përsa i përket listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit në Njësinë Administrative Nr.4, Pallati nr.120, Rruga “Aleksandër Goga”, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”, duke hequr nga lista përfituese e Aneksit 1, nr.rendor 12, z.Hasbi Resuli.
2. Miratimin e ndryshimit të VKB-së nr.35, datë 09.05.2022 “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit në Njësinë Administrative Nr.4, Rruga “Aleksandër Goga”, Pallati nr.344, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”, duke hequr nga lista përfituese e Aneksit 1, nr.rendor 14, z. Misir Soljati, znj.Luzjana Soljati.
3. Miratimin e ndryshimit të VKB-së nr.35, datë 09.05.2022 “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit në Njësinë Administrative Nr.4, Rruga “Aleksandër Goga”, Pallati nr.344, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”, duke hequr nga lista përfituese e Aneksit 1, nr.rendor 10, z. Agron Xhafa.
4. Miratimin e ndryshimit të VKB-së nr.31, datë 03.02.2023 “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit në Njësinë Administrative Katund i Ri, Rruga “Bisht Kamëz, Pallati nr.29, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”, duke hequr nga lista përfituese e Aneksit 1, nr.rendor 2, z. Agim Hodo.
5. Miratimin e ndryshimit të VKB-së nr.61, datë 28.02.2023 “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit në Njësinë Administrative Sukth, objektet e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”, duke hequr nga lista e përfituesve e Tabelës 3 “Subjektet përfituese të pallatit nr.98, rruga “Hamallë”, nr.rendor 5, z.Juventus Kodra.
6. Miratimin e ndryshimit të VKB-së nr.61, datë 28.02.2023 “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit në Njësinë Administrative Sukth, objektet e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”, duke hequr nga lista e përfituesve e Tabelës 3 “Subjektet përfituese të pallatit nr.98, rruga “Hamallë”, nr.rendor 4, z.Xhemali Cullhaj.
7. Miratimin e ndryshimit të VKB-së nr.61, datë 28.02.2023 “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit në Njësinë Administrative Sukth, objektet e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”, duke hequr nga lista e përfituesve e Tabelës 3 “Subjektet përfituese të pallatit nr.98, rruga “Hamallë”, nr.rendor 6, z.Shaban Paja, znj.Shkëndije Paja.

8. Miratimin e ndryshimit të VKB-së nr.61, datë 28.02.2023 “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit në Njësinë Administrative Sukth, objektet e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”, duke hequr nga lista e përfituesve e Tabelës 5 “Subjektet përfituese të pallatit nr.10, rruga “Shefki Elezi”, nr.rendor 12, z.Xhezmi Tafili, znj.Natasha Tafili, z.Alfred Tafili.
9. Miratimin e ndryshimit të VKB-së nr.61, datë 28.02.2023 “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit në Njësinë Administrative Sukth, objektet e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”, duke hequr nga lista e përfituesve e Tabelës 6 “Subjektet përfituese të pallatit nr.19, rruga “Vadardhë Kullë”, nr.rendor 13, z.Bujar Ocelli, znj.Harife Ocelli.
10. Miratimin e ndryshimit të VKB-së nr.36, datë 03.02.2023 “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit në Njësinë Administrative Sukth, rruga “Hamallë”, pallati nr.98, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”, duke hequr nga lista e përfituesve e Aneksit 1, nr.rendor 2, z.Muharrem Ryta.
11. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Publike, Komisioni i Posaçëm dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

ZËVENDËSKRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK Durrës

Denisa Luarasi



U shpall sot me datë 16.06.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës



Nr. 402/12 prot.

Durrës, më 18 . 06 .2025

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS

KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.21 datë 11.06.2025, “Për disa ndryshime në vendimet e Këshillit Bashkiak të listës së përfituesve , banorë në pallatet e dëmtuara në Njësitë Administrative Sukth, Katund i Ri si dhe Njësitë Administrative nr.3 dhe nr.4, Bashkia Durrës, të cilët kanë përfituar nga programi i procesit të rindërtimit të zonës së re për zhvillim , sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.164, datë 19.02.2020,” Për shpalljen e zonës së re për zhvillim, në Njësinë Administrative Durrës, Bashkia Durrës dhe caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si njësi zbatuese”.

Ky vendim në bazë të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neni 3 pika 2 nuk është akt me karakter normativ. Vendimi është akt administrativ individual bazuar në nenin 3 pika 1/a të Ligjit nr 44/2015 “Kodi e Administrative”, pasi i drejtohet subjekteve të përcaktuar individualisht duke krijuar një marrëdhënie juridike konkrete si dhe është i shteruar në zbatimin e tij.

Në bazë të Ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” (neni 8/a) i ndryshuar “Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e akteve me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore”.

Për sa më sipër verifikimi i këtij vendimi duke qenë një akt administrativ me karkater individual **nuk është në kompetencën e Prefektit të Qarkut.**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

